

KOMPANI KEDS AËS PËR QËRIMIN E KURORIT E NËKËST SHTETI
KOSOVO ELECTRICAL DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY
KOSOVSKA PRUZINA DISTRIBUCIJA I KURORIT E NËKËST SHTETI

KEDS - S.H.A.
Nr. 211 Dt. 29.04.2016
HQ 2

RAPORTI I PAJTUESHMËRISË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES 2015

Prishtinë
Prill 2016

PËRKUFIZIME

AMR: Lexues Automatik të Njësorit

ENTSO-e: Organizata Evropiane e Operatorëve të Transmisionit

FPEE: Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike

HHU: Aparatet e Dorës për Lexim

KEDS: Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a.

KESCO: Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a.

KOSTT: Operatori i Transmisionit dhe Tregut

MTI: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

OSSH: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

PP: Programi i Pajtueshmërisë

TU: Tension i Ulët

ZP: Zyrtari i Pajtueshmërisë

ZRRE: Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

PËRMBAJTJA

1. HYRJJE	1
2. DETYRIMET LIGJORE NE LIDHJE ME PROGRAMIN E PAJTUESHMËRISË	2
3. PIKËPAMJET E RAPORTIT TE PAJTUESHMËRISË	2
3.1. ZYRTARI I PAJTUESHMËRISË	3
3.2. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PUNONJËSVE TË OSSH-SË	3
3.3. MASAT PËR ELIMINIMIN E SJELLJEVE DISKRIMINUESE	3
4. REALIZIMI I PROGRAMIT TE PAJTUESHMËRISË	4
4.1. NDARJA E PASURIVE DHE LLOGARIVE	4
4.2. QENDRA E THIRRJEVE	4
4.3. KYÇJET NË RRJETIN E SHPËRNDARJES	5
4.4. KYÇJET E GJENERATORËVE	6
4.5. LEXIMET E NJEHSORËVE DHE DHËNIA E INFORMACIONIT PËR FATURIM	6
4.6. ASPEKTE TË TJERË	7
4.6.1. <i>Ndërprerja ose Reduktimi I Furnizimit së Energjisë Elektrike</i>	7
4.6.2. <i>Komunikimi me Konsumatorë</i>	9
4.6.3. <i>Shkelja e Kushteve Kontraktuale të Shpërndarjes</i>	9
4.6.4. <i>Informatat e Ndjeshme Komerciale</i>	9
4.6.5. <i>Informimi i Publikut</i>	9
4.6.6. <i>Informacioni Kontraktuar</i>	10
4.6.7. <i>Informacioni Konfidencial</i>	10
4.6.8. <i>Shërbimet e Përbashkëta</i>	10
5. PËRMBLEDHJE	10

1. HYRJE

Zyra e Rregullatorit për Energjisë në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-085 dhe Marrëveshjes për Implementim të nënshkruar ndërmjet aksionarit të KEDS, gjegjësisht Kosova-Calik Limak Energy sh.a. dhe Qeveria së Kosovës, për të shthurur e ndarë ligjërisht funksionet e distribucionin nga ato të furnizimit në KEDS para datës 31 Dhjetor 2014 ka ndërmarrë hapat e mëposhtme.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në 29 Prill 2014 ka miratuar një Udhëzues Ligjor për Sthurjen e KEDS-it, duke shpjeguar hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren në mënyrë që të plotësohet shthurja e funksioneve të shpërndarjes dhe furnizimit të KEDS-it. Të gjitha përgatitjet për ndarjen e KEDS-it janë bërë në përputhje me udhëzuesin e lëshuar nga ZRRE-ja si dhe me planit Aksionar të dërguar tek Drejtori i Përgjithshëm. (Master Action List - Kesco/Keds Split, as at 31 December 2014)

Në bazë të këtyre kërkesave Kosova Calik-Limak Energy sh.a. ka krijuar një kompani të re të quajtur Kompania Kosovare për Furnizim me Energjië Elektrike sh.a. (KESCO), të cilës do ti transferohen funksionet e furnizimit nga KEDS. Të gjitha gjithë detyrimet e parapara në planin Aksionar për shthurje janë plotësuar duke përfshirë informimin e konsumatorëve për Furnizuesin e ri, njoftimin e punonjësve, ndarjen e pasurive para 31 Dhjetorit 2014.

Ndarja e funksioneve ndërmjet kompanive KEDS dhe KESCO është bërë duke respektuar funksionet të cilat ato duhet ti kryejnë sipas kushteve të parapara në licencë. Të gjitha funksionet (shkycje/ri-kycje, leximi i njehsorëve etj), që në të kaluarën janë kryer nga Furnizuesi Publik kanë kaluar si funksione të OSSh-së të parapara me licencë. Në këtë kuptim viti 2015 është viti i parë i organizimit të OSSh-së sipas funksioneve të parapara në licencën përkatëse.

KESCO ka pranuar vendimin e ZRRE-së V_670_2014 për transferimin e Licencës së Furnizimit nga KEDS për të kryer funksionin e Furnizuesit Publik dhe ka filluar operimin nga 1 Janari i vitit 2015. Si rrjedhojë, KEDS ka transferuar në këtë kompani të gjitha kontratat, pasuritë, punonjësit dhe detyrimet që kane pasur të bëjnë me funksionet e Furnizimit.

Nga data 01 Janar 2015, Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike mban Licencën për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes me Numër ZRRE/Li/Tr_06/12. Në bazë të kushteve të kësaj licence dhe bazuar në vendimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë të datës 16 Korrik 2015 me Numër V_750_2015 i licencuari ka përgatitur Raportin e Pajtuëshmërisë për vitin 2015.

2. DETYRIMET LIGJORE NE LIDHJE ME PROGRAMIN E PAJTUESHMËRISË

Operatori i Sistemit të shpërndarjes ka përgatitur Programin e Pajtuëshmërisë, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike Numër 03/L-201 dhe nenit 18 të Licencës të cilët detyrojnë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për të përgatitur Programin e Pajtuëshmërisë dhe Zyrën e Rregullatorit të Energjisë të miratojë atë. Me këtë qëllim OSSh-ja ka dërguar për miratim në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë me date 01 Korrik 2015 Programin e Pajtuëshmërisë dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka miratuar atë me date 16 Korrik 2015 me vendimin Numër V_750_2015.

Raporti i Pajtuëshmërisë është përgatitur në bazë të detyrimeve ligjore të lartpërmendura dhe Programit të Pajtuëshmërisë të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

3. PIKËPAMJET E RAPORTIT TE PAJTUESHMËRISË

Duke u bazuar në Programin e Pajtuëshmërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të përcaktojë në veçanti:

1. Zyrtarin e Pajtuëshmërisë për monitorimin e Programit të Pajtuëshmërisë dhe raportimin në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë ashtu si kërkohet në nenin 18 të Licencës së OSSh-së.
2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësve të operatorit të sistemit të shpërndarjes për të përmbushur qëllimin Programit të Pajtuëshmërisë.

3. Masat për eliminimin e sjelljeve diskriminuese në raport me pjesëmarrësit e tjerë në tregun e energjisë elektrike.

3.1. Zyrtari i Pajtueshmërisë

Programi i Pajtueshmërisë thekson që OSSh-ja duhet të emërojë një Zyrtar të Pajtueshmërisë me efekt nga muaji Korrik 2015 që të jetë përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë, si dhe për dorëzimin e Raportit të Pajtueshmërisë në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Gjithashtu Programi i Pajtueshmërisë parashikon që Zyrtari i Pajtueshmërisë do të monitorojë respektimin e Programit të Pajtueshmërisë dhe detyrimeve ligjore që përmbahen në të dhe është përgjegjës për çdo përshtatje ose ndryshim të Programit të Pajtueshmërisë me procedurën e aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka caktuar z. Ermal Koçi në detyrën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë me datë 31 Korrik 2015.

3.2. Të Drejtat Dhe Përgjegjësitë e Punonjësve të OSSh-së

Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të OSSh-së janë parashtruar në Kodin e Etikës, Kodin e Distrikteve, Rregulloret e Brendshme dhe në formularët e përshkrimit të vendit të punës. Secili punonjës duke nënshkruar formularin e përshkrimit të vendit të punës pranon të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e punës.

OSSH-ja për punëtorët e rinj ka një program orientimi në mënyrë që punëtorët të njihen dhe familjarizohen me procedurat dhe rregulloret e kompanisë.

Kompania sa herë që e shikon të arsyeshme mban vazhdimisht takime specifike me qëllim trajnimi të punonjësve në lidhje me freskimin, modifikimin dhe njohjen me procedura e reja.

3.3. Masat për Eliminimin e Sjelljeve Diskriminuese

Nuk ka pasur sjellje diskriminuese. Te gjitha masat për eliminimin e sjelljeve diskriminuese janë marrë dhe janë parashtruar në raport.

4. REALIZIMI I PROGRAMIT TE PAJTUESHMËRISË

Fushat kryesore janë:

1. Ndarja e pasurive dhe llogarive.
2. Qendra e thirrjeve.
3. Kyçjet në Rrjetin e Shpërndarjes.
4. Kyçjet e gjeneratorëve
5. Leximet e njehsorëve dhe dhënia e informacionit për faturim.
6. Aspekte të tjerë

4.1. Ndarja e Pasurive dhe Llogarive

KEDS në përputhje me planin e veprimit për shthurje ka ndarë pasuritë nga Furnizuesi si dhe ka llogari bankare të veçantë, në të cilën të hyrat e pranura depozitohen dhe pagesat bëhen nga ajo llogari.

4.2. Qendra e Thirrjeve

Qendra e thirrjeve si funksion është transferuar në Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO).

Bazuar në marrëveshje midis kompanive informacioni në Qendrën e Thirrjeve është ditor dhe rrjedha e informacionit është nga KEDS tek KESCO dhe anasjelltas.

Informacioni që transmetohet nga KEDS tek KESCO është përmbledhur si më poshtë.

1. Informata për planin e mirëmbajtës së rrjetit dhe zonat e konsumatorëve që ndikohen gjatë mirëmbajtjes.
2. Informata për defektet e rrjetit dhe kohën që duhet për riparimin e tyre.
3. Informata të tjera të ndryshme në lidhje me problemet e rrjetit shpërndarjes.

Konsumatorët mund të thërrasin në Qendrën e Thirrjeve 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë për problemet të ndryshme. Për problemet që operatorët e Qendrës së Thirrjeve nuk mund të përgjigjen në mënyrë të menjëhershme “hapet një detyrë” në sistemin kompjuterik të Qendrës së

Thirrjeve. Operatorët e Qendrës së Thirrjeve kodojnë problemin dhe e dërgojnë atë në departamentet relevante të KEDS ose KESCO.

4.3. Kyçjet në Rrjetin e Shpërndarjes

Konsumatorët që kërkojnë kapacitet të lartë bëjnë kërkesë në departamentin e Pëlqimeve Energjetikë në KEDS. Mbas aprovimit të kërkesës konsumatori mund të kyçet në sistemin e rrjetit të shpërndarjes.

Kyçja e konsumatorëve shtëpiak bëhet në bazë të kërkesës që konsumatorët i bëjnë në zyrat e departamentit për Përkujdesen ndaj Konsumatorëve tek KESCO.

Çdo konsumator i ri duhet të kyçet në rrjetin e shpërndarjes dhe kyçja e re kërkon ose ndërtimin e një rrjeti plotësisht të ri, ose zgjerimin e rrjetit ekzistues. Parimet kryesore të kyçeve të reja janë:

Si konsumatorët ekzistues edhe ata të rinj trajtohen në mënyrë të barabartë.

1. Asnjë kyçje e re nuk duhet të shkaktojë asnjë efekt negativ të konsumatorët ekzistues, dhe kyçjet e reja nuk duhet të ndikohen nga ndikimet negative të konsumatorëve ekzistues.
2. Të gjithë konsumatorët e kyçur në rrjetin e energjisë elektrike duhet të jenë në gjendje t'i përmbushin detyrimet e tyre dhe të kenë funksionim dhe mirëmbajtje me cilësi të lartë të instalimeve të tyre.
3. Me rastin e një kyçje të re ose modifikimit të saj, konsumatorët duhet të këshillohen për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë transparente dhe standarde.

Tarifat e kyçeve janë strukturuar ashtu që të mbulojnë shpenzimet e caktuara që shkaktohen në procesin e kyçjes. Për konsumatorët shtëpiak këto shpenzime parashihen lehtë dhe janë të paracaktuara nga Rregullatori. Megjithatë, në lidhje me konsumatorët e biznesit, këto nuk mund të parashikohen pasi që kryesisht varen nga kërkesa specifike e konsumatorit. Tarifat e kyçjes për kërkesa specifike përcaktohen në procesin e dhënies së lejes për kyçje, e cila gjithashtu e përcakton kufirin e kyçjes që është me rëndësi kritike sa i përket matjes së energjisë së konsumuar si dhe pronësisë mbi pajisjet e sapo ndërtuara. Faza e hulumtimit dhe projektimit

është e rëndësishme ashtu sikurse edhe përcaktimi i pikës më të mirë të mundshme të kyçjes që e siguron stabilitetin të rrjetit dhe cilësinë e shërbimit të ardhshëm dhe kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht lidhja më e shkurtër e mundshme.

Në rastet kur për qëllime të kyçjes objektet energjetike do të ndërtohen në pronën e konsumatorit, konsumatori duhet që ose t'i bartë operatorit të rrjetit pronësinë e tokës ose të drejtën e ndërtimit dhe të drejtën e qasjes në objektet e energjisë për të siguruar qasje të papenguar në rast të mirëmbajtjes, inspektimit dhe emergjencave.

Aktualisht, kyçjet e reja kryhen në përputhje me kodet ekzistuese teknike të miratuara nga ZRRE-ja, dhe KEDS-i është në proces të finalizimit të një metodologjie më gjithëpërfshirëse për tarifën e kyçjes në shpërndarje për ti përmirësuar më tej praktikën ekzistuese.

4.4. Kyçjet e Gjeneratorëve

Kyçjet e gjeneratorëve në nivelin e distribucionit janë bërë në përputhje me procedurat dhe ligjet përkatëse në fuqi në mënyrë pa e dëmtuar gjeneratorët e ri gjithashtu pa dëmtuar rrjetin aktual. Zgjidhjet teknike bëhen në mënyrë që të arrihet pika optimale teknike dhe ekonomike.

4.5. Leximet e Njësorëve dhe Dhënia e Informacionit për Faturim

Leximi i njësorëve është në përgjegjësinë dhe është funksion i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Planet e leximit të njësorëve akordohen midis KESCO dhe KEDS.

Leximi i njësorëve bëhet në mënyrë bashkohore me aparatet e dorës për lexim (HHU). Informatat e leximit të njësorëve ngarkohen direkt nga aparati i dorës në sistemin kompjuterik të KESCO. Në bazë të informacionit të marrë nga HHU KESCO llogaritet dhe shtypet faturën e konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët relevant.

Leximi për konsumatorët e mëdhenj bëhet me anë të “njësorëve të zgjuar” (smart meter, AMR) dhe faturat llogariten dhe shtypen duke u bazuar në informatat që këta njësorë dërgojnë direkt në sistem.

Në baza mujore OSSh-ja përgatit të dhënat për energjinë e shpërndarë në grupe tarifore dhe lëshon faturën për ngarkesën e shfrytëzimit të sistemit të cilën e dërgon në KESCO.

Me pas KESCO mbasi bën rikonsulimin e të dhënave përgatit faturën për humbjet e energjisë elektrike të cilën e dërgon në KEDS.

KESCO njofton me shkrim konsumatorët që mospagimi i faturave të energjisë mund të sjellë si pasojë mos furnizimin me energji elektrike. Gjithashtu departamenti i Përkujdeset për konsumatorë në koordinim me Qendrën e Thirrjeve njofton konsumatorët në lidhje me pagesat e faturave. Pagesa e faturave behën në pikat e arkëtimit të KESCO-s, gjithashtu në bankat e nivelit të dytë duke pasur mundësinë edhe për pagesa elektronike, në zyrat e Postes së Kosovës dhe në institucionet e tjera financiare.

4.6. Aspekte të Tjerë

Në faqet në vijim janë përfshirë aspekte të tjerë në lidhje me Programin e Pajtuëshmërisë.

4.6.1. Ndërprerja ose Reduktimi I Furnizimit së Energjisë Elektrike

Në lidhje me ndërprerjet e furnizimit, ekzistojnë dy arsye kryesore:

1. Ndërprerjet e planifikuara.
2. Ndërprerjet e paplanifikuara

Ndërprerjet e paplanifikuara ndikohen kryesisht nga kushtet e motit dhe nga mbingarkesa e rrjetit në zona të caktuara. OSSH-ja është e angazhuar që të zvogëlojë numrin e ndërprerjeve të paplanifikuara duke i krijuar dy departamente të veçanta, Mirëmbajtjen Preventive dhe Ekipet Emergjente. OSSH-ja ka arritur të zëvendësojë mbi 160 trafo, 13.000 shtylla, 710 TU kuti, 120 nënstacione të reja, 630 km kablllo të largpërçuesve, 130 km kablllo nëntokësore, 31 km përçues të largpërçuesve, mbi 13.000 izolator dhe punë të tjera përkatëse.

Përveç kësaj, KEDS-i ka vazhduar praktikën e renditjes së daljeve sipas kategorive ABC dhe A+, e cila ishte zhvilluar më parë duke shtuar, kur kjo ka qenë e mundur, konsumatorët e ndjeshëm në kategorinë A+ nëse kushtet teknike e lejojnë. Duhet të theksohet se pavarësisht klasifikimit A+, ndërprerjet e paplanifikuara mund të ndodhin për shkak të kushteve të ndryshme të cilat janë jashtë kontrollit të operatorit të shpërndarjes - probleme mund të ndodhin në nënstacionet e transmisionit, kushtet ekstreme të motit mund të dëmtojnë linjat etj. OSSH-ja është e obliguar të operojë dhe ta mirëmbajë një rrjet të sigurt, të besueshëm dhe efikas, dhe si i tillë ka

punuar për ti minimizuar ndërprerjet e tilla. OSSh-ja është duke e përmirësuar komunikimin me konsumatorët duke krijuar një ekip të llogarive kryesore dhe ka filluar bashkëpunimin me odat e ndryshme të tregtisë si dhe me MTI-në për të siguruar komunikim më të drejtpërdrejtë në mes të OSSH-së/FPEE-së dhe konsumatorëve.

Një tjetër arsye për ndërprerje të paplanifikuara është devijimi i prodhimit vendor nga plani, dhe Operatori i Tregut aktualisht nuk është në pozitë për ta kryer rolin e tij të plotë operacional. Pasi që energjia nuk mund të ruhet, praktika në mbarë botën është që energjia kontraktohet një ditë më herët, pra gjeneratorët vendorë parashikojnë një ditë më parë se sa ata do të prodhojnë ditën e ardhshme, FPEE-ja në të njëjtën kohë parashikon konsumin e pritur të konsumatorëve dhe pastaj e kontraktin importin e nevojshëm për të siguruar që konsumi i parashikuar të mbulohet nga energjia e brendshme dhe e importuar. I gjithë ky proces kontrollohet dhe verifikohet nga KOSTT-i si Operator i Tregut. Të nesërmen, çfarëdo devijimi nga plani duhet të mbulohet nëpërmjet kapaciteteve rezervë / importit shtesë nga ana e Operatorit të Tregut. Megjithatë, për momentin Kosova ende nuk njihet plotësisht nga ENTSO-e (Organizata Evropiane e Operatorëve të Transmisionit), dhe nuk është në gjendje t'i sigurojë rezervat e nevojshme për funksionimin e duhur të tregut. Gjithashtu, duhet të theksohet se, në 4-5 orët e para të një ndërprerje emergjente (d.m.th. të paplanifikuar) të njësisive të prodhimit, asnjë energji shtesë nuk mund të arrijë në vend dhe nevoja për ta ruajtur bilancin e sistemit në Kosovë dhe në rajon duhet të bëhet duke kufizuar konsumin nëpërmjet aplikimit të ndërprerjes së energjisë elektrike. Ndërprerja e energjisë elektrike zbatohet duke përdorur klasifikimin ekzistues ABC të daljeve (në bazë të humbjeve dhe arkëtimit) dhe përdoret në raste të rralla si mjete i fundit për të siguruar stabilitetin e sistemit. Normalisht, daljet A dhe A+ janë shumë rrallë objekt i masave të tilla, por megjithatë edhe ato mund të preken në varësi të madhësisë së devijimit.

Për të siguruar bilancin dhe për t'i kufizuar masat e tilla negative, në situata të tilla KOSTT-i dhe KESCO punojnë ngushtë me njëri tjetrin. Për vitin 2015 energjia e pa furnizuar është ulur për rreth 25% në 1.2% të konsumit të përgjithshëm në vend. Shpresojmë se të gjitha veprimet e ndërmarra nga KOSTT-i, Qeveria dhe aktorët e tjerë të energjisë do të njihen nga ENTSO-E në vitin 2016 dhe do të kemi një sistem më të mirë të punës me më pak ndërprerje në të ardhmen.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes bën ndërprerje të shpërndarjes vetëm dhe vetëm në baze të planit të mirëmbajtjes së rrjetit. Plani i mirëmbajtjes i komunikohet KESCO dhe gjithashtu është publik në faqen elektronike të KEDS.

Për defektet dhe ndërprerjet e pa planifikuara dhe problemet teknike dhe operative KESCO njoftohet menjëherë.

Reduktimet e energjisë elektrike OSSh-ja i bën duke u bazuar në informacionet e marra nga KESCO dhe KOSTT në lidhje me devijimet e planit të furnizimit. OSSh nuk është përgjegjëse për balancimin e sistemit, vetëm ndjek instruksionet nga KOSTT dhe KESCO në baza ditore.

4.6.2. Komunikimi me Konsumatorë

Komunikimi me konsumatorët bëhet ndërmjet departamentit Marrëdhënieje me Publikun dhe departamentit Përkujdesja ndaj Konsumatorit me ane të komunikatave në media, publikimet në faqet elektronike të kompanisë, rrjeteve sociale, poste elektronike etj.

4.6.3. Shkelja e Kushteve Kontraktuale të Shpërndarjes

Nuk është evidentuar ndonjë transferim informacioni tek ndonjë palë tjetër në lidhje me kushtet kontraktuale.

4.6.4. Informatat e Ndjeshme Komerciale

OSSH-ja si monopol që është nuk ndan në mënyrë diskriminuese informata të ndjeshme komerciale. OSSh-ja ka marrë masat e duhura duke ndarë sistemet dhe përgatitur procedurat e nevojshme që mbështesin dhe detyrojnë jo diskriminimin e aktoreve të tregut.

4.6.5. Informimi i Publikut

OSSH-ja informon vazhdimisht publikun për Përshkrimin e Sistemit të Shpërndarjes, Planet Zhvillimorë, Rregullat për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe informacione të ndryshme si edhe format e aplikimeve. Të gjitha këto informacione përditësohen sa herë që është nevoja dhe të gjitha informacionet në fjalë publikohen në faqen elektronike të OSSH.

4.6.6. Informacioni Kontraktuar

Informacionet që lindin nga kontratat nuk i shpalosen palës se tretë ne përputhje me ligjet adekuate të Republikës së Kosovës.

4.6.7. Informacioni Konfidencial

OSSH-ja ka marre masat që informacionet e fshehta të mos dekonspirohen. Rregulloret, procedurat dhe urdhëresat e brendshme përputhen me ligjet në fuqi për informacionet e ndejshme. Një numër i kufizuar i punonjësve kanë qasje në informacionet e ndejshme dhe siguria e tyre monitorohet vazhdimisht.

4.6.8. Shërbimet e Përbashkëta

Me qëllim të eliminimit të rrezikut për rritjen e kostove për të dy entitetet ligjërisht të ndara, e që do të rezultonte në dyfishimin e funksioneve dhe respektivisht çmime më të larta për konsumatorët fundor. ZRRE-ja me anë të vendimit V_619_2014 ka udhëzuar që shërbimet e përbashkëta (si: IT, financa, çështjet legislative, etj) të kryhen nga OSSH-ja, bazuar në një marrëveshje në mes të OSSH-së dhe FPEE-së. Ka pasur disa përfitime nga zbatimi i konceptit të shërbimeve të përbashkëta, së pari koncepti mbështet zbatimin e legjislacionit evropian për paketën e dytë dhe të tretë të ndarjes së proceseve, së dyti siguron përfitime mbi centralizimin e proceseve dhe në këtë mënyrë sjell përfitime dhe mundësi për të standardizuar dhe automatizuar proceset, përdorimin e përbashkët të infrastrukturës duke ndarë kështu kostot e tyre.

5. PËRMBLEDHJE

Programi i Pajtueshmërisë në lidhje me mos diskriminimit e aktoreve të tregut dhe funksionimit të pavarur të OSSH-së dhe ndarja e bizneseve të shpërndarjes dhe furnizimit është realizuar me sukses.

Edhe sepse është viti i parë që OSSh-ja po kryen funksionet që janë parashkruar në licencën në fjalë, unë jam i kënaqur që korniza e themeluar është gjithëpërfshirëse, është duke funksionuar në mënyrë efektive dhe është testuar dhe shqyrtuar në mënyrë adekuate.

Ky Raport i Pajtushmërisë është paraqitur për miratim te Bordi Drejtues i KEDS-it.

Ermal Koçi

Zyrtar i Pajtushmërisë

